



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.A.nr.210/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skënder Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljeve Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, në Zgjedhjet e Lokale, të mbajtura më 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 15.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa ZL.Anr.210/2025 e datës 14.10.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, në Zgjedhjet Lokale, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 500.00€ (pesë qind euro).

III. Detyrohet Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 14.10.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendon se më datë 12 tetor 2025, në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve, kur ishte në fuqi heshtja zgjedhore, në rrjetin social instagram kandidati për asamble nga radha e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Sami Boroci, ka publikuar dhe sponsorizuar për më shumë visibilitet, një material me përmbajtje qartësisht propaganduese, ndonëse periudha e heshtjes zgjedhore ka hyrë në fuqi. Ky veprim ka përben shkelje të rregullave zgjedhore, neni 37 të LPZ-së, Nr.08/L-228.

Kërkojnë nga PZAP-ja që të konstatojë se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka shkelur heshtjen zgjedhore, të shpallë masën përkatëse ligjore ndaj subjektit politik dhe personit përgjegjës. Si provë kanë bashkëngjitur fotografinë nga profili i Sami Boroci në instagram, e cila e përmban datën dhe kohën e publikimit.

Në përgjigje në ankesë Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës kanë deklaruar se postimi i përmendur është pjesë e një plani komunikimi njëmuor dhe nuk është krijuar, përgatitur apo iniciuar në ditën e zgjedhjes, se postimet janë përgatitur me kohë, duke u planifikuar për publikim automatik sipas kalendarit mediatik të subjektit politik. Tutje në përgjigje theksohet se ligji ndalon bërjen e fushatës në ditën e heshtjes zgjedhore, por nuk ndalon postime të planifikuara paraprakisht, të cilat dalin çdo ditë sipas marrëveshjes dhe nuk bëhen që në ditën e zgjedhjeve të publikohen, dispozita ligjore ka për synim ndalimin e aktiviteteve të drejtpërdrejta, të reja që synojnë të ndikojnë mbi vullnetin e votuesve atë ditë. Tutje, në përgjigje kanë shtuar se pala ankuese nuk ka ofruar prova se postimi është bërë në datën 12.10.2025, se një postim i shpërndarë në rrjete sociale nuk përbën dëshmi të mjaftueshme për të provuara shkelje, derisa mungon verifikimi i kohës së publikimi të origjinalit. Për faktin se postimi në fjalë nuk përmban as thirrje të drejtpërdrejta për të votuar ditën e zgjedhjeve, dhe në mungesë të provave të qarta kërkojnë nga PZAP që ta refuzoj ankesën si të pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

- Ankesa është e bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), vlerësoj se pretendimet e Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), janë të bazuara dhe si të tilla i aprovoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet *”Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*, e po ashtu edhe nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores 07/2024, ku parashihet se *”Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.5. shfrytëzimi i mediave lokale ose ndërkombëtare dhe rrjeteve sociale me qëllim të ndikimit tek votuesi”*.

Paneli ka konsideruar këtë veprim si shkelje të nenit 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi veprimi është bërë gjatë heshtjes zgjedhore e që ka për qëllim ndikimin tek votuesit.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesë janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, pasi që me provat e

bashkëngjitura në ankesë vërtetohet se kandidati për asamble nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës Sami Boroci, ditën e zgjedhjeve, përkatësisht me 12 tetor 2025, në orën 12:03 ka publikuar fotografi në profilin e tij në rrjetin social Instagram fotografi duke e thyer kështu heshtjen zgjedhore. Kjo shkelje ka të bëjë me faktin se veprimi i përshkruar në ankesën e parashtruar është në kundërshtim me dispozitat e nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228 dhe nenit 8 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Rregullores zgjedhore 07/2024, po ashtu fakti Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë ditës së votimit, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkruara në ankesa nga parashtruesit e ankesave paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtat i pranoi si të bazuara.

Paneli, konform nenit 13 par. 7 të Rregullores Nr. 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosies së Ankesave, me të cilin parasheh *"Paneli para se të vendos lidhur me ankesën mund të kryej hetim nëse e konsideron të nevojshme dhe të arsyeshme."* Andaj Paneli ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se e njëjta është e bazuar, pasi që nga hulumtimi dhe verifikimi në rrjetin social instagram shihet se i njëjti ka bërë publikimin me datën 12 tetor 2025, në ditën e votimit.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e lehtë të shkeljes si dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nënën 117 paragrafi 3, nën 118 paragrafi 1 dhe nën 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, si dhe nën 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL.Anr.210/2025 më datën 15.10.2025

Kryesues i Panelit

Arsim Hamzaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa në kuptim të nenit 118.4 të LZP-së.